**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
Ministria e Mjedisit ,Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine, Prostornog planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment , Spatial Planning and Infrastructure

Ministri i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar ne dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe nenit 8 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit te komisionit profesional, nxjerr këtë

## VENDIM

**I. Aprovohet,** kërkesa nr.11231 date 05.12.2025 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus NT"Bres Tours" Sherif Salihi B.I.,me seli në Dragash për marrjen e nisjeve ne relacionin: Prizren-Suharekë-Prishtine me orare te nisjes (09:15-12:00).

*Arsyetim*

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus NT"Bres Tours" Sherif Salihi B.I, me seli në Dragash, **ka plotësuar** kushtet ligjore për ndarjen e nisjeve të lira në relacionet e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes

publike për marrjen e nisjeve ne relacionin: Prizren-Suharekë-Prishtine me orare te nisjes (09:15-12:00).

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

**Hysen Durmishi**

U.D.Ministër

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Deparatmentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.